

**Mbështeteni themelimin e
KOMRA-s!**



**e mbështes
KOMRA-n**



Koalicioni për KOMRA-n, korrik 2015.

www.recom.link

www.facebook.com/ZaREKOM.PerKOMRA.ForRECOM

Twitter: [@REKOM_KOMRA](https://twitter.com/REKOM_KOMRA)



KOMRA është shkurtësë e emërtimit të Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish RSFJ-së nga data 1 janar e vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001, për themelimin e të cilit angazhohet rrjeti i organizatave të shoqërisë civile nga vendet post-jugosllave (Koalicioni për KOMRA-n), i cili numëron 2.050 anëtarë. Koalicionin për KOMRA-n e përbëjnë organizatat dhe aktivistët për të drejtat e njeriut, shoqatat e familjeve të personave të zhdukur/refugjatëve/veteranëve dhe shoqatat e ish-të burgosurve në kampet e përqendrimit, anëtarët e familjeve të viktimave të luftës, artistët, shkrimtarët, gazetarët, juristët, hulumtuesit dhe individë të tjerë, të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në promovimin e idesë së themelimit të Komisionit Rajonal.

Nismën për themelimin e Komisionit Rajonal në vitin 2006 e kanë filluar tri organizata relevante për të drejtat e njeriut: Fondi për të Drejtën Humanitare (Serbi), Documenta (Kroaci) dhe Qendra Hulumtuese-dokumentuese (Sarajevë).

Koalicioni për KOMRA-n është themeluar në datën 28 tetor të vitit 2008 në Prishtinë. Pas debatit katërvjeçar mbi qëllimet, detyrat dhe aktivitetet e Komisionit të ardhshëm Rajonal, **Koalicioni, në datën 26 mars të vitit 2011, e ka miratuar Propozim-Statutin e KOMRA-s.**

Koalicioni, në muajin maj dhe qershor të vitit 2011, në 13 qytete të vendeve post-jugosllave e ka organizuar fushatën për themelimin e KOMRA-s, gjatë së cilës **550.000 qytetarë e kanë nënshkruar peticionin për themelimin e Komisionit Rajonal.**

Nga fundi i muajit qershor të vitit 2011, Koalicioni për KOMRA-n, peticionin me 550.000 nënshkrime dhe me Propozim-Statutin e KOMRA-s ua ka dorëzuar kryetarëve të asaj kohe të vendeve post-jugosllave, duke iu bërë thirrje që ta themelojnë komisionin ndërshtetëror, i cili do të konstatonte faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, i cili do të përpilonte evidencën emër për emër të njerëzve, të cilët e kanë humbur jetën në luftërat në hapësirën e ish-Jugosllavisë në periudhën prej muajit janar të vitit 1991 e deri në muajin dhjetor të vitit 2001, dhe i cili do të sajonte regjistrin e kampeve të përqendrimit dhe të objekteve të tjera të burgosjes si dhe do të pranojë padrejtësitë e shkaktuara viktimave.

Me qëllim të bartjes së Nismës në nivel politik, Koalicioni, në muajin shtator të vitit 2011 ka kërkuar nga kryetarët e shteteve për të emëruar të dërguarit e tyre për KOMRA-n, me detyrën që të japin mendimin e tyre mbi Propozim-Statutin e KOMRA-s në kontekstin e mundësive juridike dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-s.

Kryetarët dhe Presidenca e B dhe H e kanë pranuar propozimin e Koalicionit dhe, si të **dërguar personal për KOMRA-n** i kanë emëruar këto personalitete të shquara: prof. dr **Zllata Gjurgjeviqin**, e dërguar e kryetarit të Kroacisë; gjyqtarin **Sinisha Vazhiqin**, i dërguar i kryetarit të Serbisë; **Luben Arnaudoskin**, zëvendës-sekretar i përgjithshëm për çështje ligjore dhe organizative në kabinetin e kryetarit të Maqedonisë; prof. dr **Sonja Tomoviç Shundiçin**, e dërguar e kryetarit të Malit të Zi; **Selim Selimin**, këshilltar ligjor i presidentes së Kosovës; **Aljoshja Çamparën**, nënkryetar i Sarajevës, i dërguar i anëtarit boshnjak të Presidencës së B dhe H; dhe **Goran Mihaljeviqin**, ekspert ligjor për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, i dërguar i anëtarit kroat të Presidencës së B dhe H.

Të dërguarit për KOMRA-n, pas një pune njëvjeçare të përbashkët dhe të konsultimeve me kryetarët/Presidencën e B dhe H, në datën 28 tetor të vitit 2014, ia kanë dorëzuar Koalicionit dokumentin e **Ndryshimeve të Statutit të KOMRA-s.**

Kuvendi i Koalicionit në datën 14 nëntor të vitit 2014 i ka shqyrtuar *Ndryshimet e Statutit të KOMRA-s* dhe i ka përkrahur ato pa asnjë vërejtje. Koalicioni ka vlerësuar se „thelbi i propozimeve të Statutit është ruajtur, se heqja e autorizimeve represive i eliminon dyshimet se KOMRA i merr kompetencat e organeve gjyqësore dhe se procedura e kandidimit dhe e zgjedhjes së këshillave të përzgjedhjes dhe e anëtarëve dukshëm është thjeshtësuar“. Koalicioni për KOMRA-n i ka përkrahur ndryshimet në financimin e Komisionit, me të cilat është paraparë që KOMRA të financohet me donacione vendore dhe të huaja, si dhe me mjetet e organizatave ndërkombëtare dhe jo nga kontributet e shteteve, ashtu siç ka propozuar Koalicioni. Koalicioni posaçërisht e përhëndet qëndrimin e të dërguarve që në mesin e qëllimeve të Komisionit të jetë edhe „përparimi i programeve arsimore në përpunje me faktet, të cilat i konstaton Komisioni.“

Në ndërkohë, në B dhe H është zgjedhur Presidenca e re, kurse në Kroaci kryetarja e re. Para Koalicionit qëndron detyra që ta sigurojë përkrahjen e liderëve të ri – të Dragan Çoviçit, anëtarit kroat, dhe Mladen Ivaniçit, anëtarit serb të Presidencës së B dhe H, si dhe të Kolinda Grabar Kitaroviçit, kryetares së Kroacisë. Lidhur me këtë i nevojitet prapë një mbështetje e fuqishme publike.

Lajm i mirë: Kryeministri serb Aleksandar Vuçiq, më 6 korrik 2015, pas një takimi që pati me avokuesit publik të Nismës për KOMRA, mediave iu tha se Qeveria Serbe është duke i dhënë mbështetje të plotë krijimit të këtij komisioni rajonal.